

Avdullah (Ali) Morina

(8.04.1947, shqiptar nga Astrazupi/Ostrozub, komuna Malishevës/Mališevo, zjarrfikës, nëntë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Muharrem (Hasan) Hoxha

(8.01.1974, shqiptar nga Prizreni/Prizren, student, pjesëtar i UÇK-së)

Avdullahu ka qenë zjarrfikës në Gjakovë/Đakovica. Në muajin prill të vitit 1998, aderoi në UÇK. Muharremi ishte student i ekonomisë. Ka qenë organizator i protestave të shumta gjatë viteve të nëntëdhjeta. Nga mesi i muajit qershor të vitit 1998, ka shkuar në Shqipëri dhe pas kthimit u bë pjesëtar i UÇK-së. Në datën **28.07.1998**, gjatë luftimeve mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe në Astrazup/Ostrozub, Muharremi dhe Avdullahu ishin duke e varrosur kushëririn e Avdullahut, Sofije Morina, trupin e pajetë e së cilës atë ditë e kishin sjell nga Gjermania. E hapën varrin në afërsi të shtëpisë së Avdullahut [Astrazup/Ostrozub]. Në çastin kur e kanë kryer varrimin, pranë tyre ka eksploduar një predhë duke i lënë që të dy të vdekur në vend. Në datën 30.07.1998, vëllai i Muharremit, Hyseni dhe pjesëtari i UÇK-së, Nuhi Hoxha, u kthyen në fshat dhe i gjetën trupat e Avdullahut dhe Muharremit. I varrosën në vendin e quajtur *Kroni i Canit/Caniev izvor*. Pas lufte, më 15.09.1999, mbetjet mortore të Avdullahut dhe Muharremit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Malishevë/Mališevo.

Burimet: deklarata H.H, FDH-34995; deklarata A.M, FDH-33015; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-18553.

Hasan (Xhemë) Krasniqi

(22.08.1952, shqiptar nga Tërpeza/Trpeza, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor ndërtime, pesë fëmijë)

Familja e Hasanit me vëllain e tij Destanin me familje e kanë braktisur **Tërpezën/Trpeza**, më 25.07.1998. Hasani nuk deshë ta linte bagëtinë vetëm dhe ndenji në shtëpi. Familjarët e tij u strehuan në fshatin fqinj të Lladrocit/Ladrovac, e pastaj kaluan në Senik. Tri ditë më vonë, më

28.07.1998, Destani u kthye në Tërpezë/Trpeza, për ta vizituar të vëllain. I gjeti shtëpitë e shkruvuara. Vendasi Sheremet Krasniqi i tha se atë ditë i kishte parë disa policë serbë duke e çuar Hasanin drejt përroskës së fshatit dhe se nga ai çast nuk dinte më asgjë për fatin e tij. Destani u nis në kërkim të të vëllait, por pa sukses. Hasanit i është humbur çdo gjurmë nga ajo ditë. Në evidencën e KNKK-së, zhdurka e tij është regjistruar në lëndë me numër BLG-801563-01.

Burimet: deklarata Q.K, FDH-15993; J. Osmani, *Krimet...*, I, 541; KNKK, *Persona të zhdurkur...*, FDH-9795.

Rasim (Daut) Krasniqi

(07.11.1940, shqiptar nga Tërpeza/Trpeza, komuna e Malishevës/Mališevo, mësues, tre fëmijë)

Ajet (Rifat) Krasniqi

(15.05.1947, shqiptar nga Tërpeza/Trpeza, komuna e Malishevës/Mališevo, tregtar, gjashtë fëmijë)

Rasimi ka qenë mësues në shkollën fillore të **Tërpezës/Trpeza**. Axha i tij Ajeti punonte në kooperativën bujqësore në Komaran/Komorane [Glllogoc/Glogovac]. Kur më **28.07.1998**, nga ora 10:00, forcat serbe e sulmuan Tërpezën/Trpeza, familjet e Rasimit dhe të Ajetit e kanë braktisur fshatin, ndërkaq Rasimi dhe Ajeti mbetën vetëm në shtëpi. Gjatë tre muajve në vijim, familjarët e Rasimit dhe Ajetit nuk kishin kurrfarë lajmesh për fatin e tyre. Në fund të tetorit, pasi u kthyen në fshat, familjarët i kanë gjetur trupat e karbonizuar të Rasimit dhe të Ajetit. Kanë qenë në afërsi të postbllokut policor në Lladroc/Ladrovac, në vendin e quajtur *Rrezja e Lladrocit/Ladrovački zrak*. Rasimin e njohën në bazë të dhëmbëve, ndërkaq Ajetin sipas këpucëve dhe këmishës. Familjarët i kanë varrosur Rasimin dhe Ajetin në varrezat e Tërpezës/Trpeza, në praninë e vëzhgueseve të OSBE-së dhe gazetarëve të *RTV Prishtinës*.

Burimet: deklarata S.K, FDH-15987; deklarata A.K, FDH-32792; deklarata M.K, FDH-32793; deklarata A.LI, FDH-34640; deklarata B.H, FDH-2976; deklarata E.H, FDH-12199;